



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2023

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 6 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 1432 Prot., datë 21.02.2023, referuar nenit 14§2§b të Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Këshilli i Lartë Gjyqësor, jo vetëm për shkak të detyrimit ligjor, por edhe për shkak të nevojave që kanë gjykatat për gjyqtarë, ka patur prioritet të punës së saj emërimin e kandidatëve magjistratë të diplomuar dhe caktimin e tyre në pozicion. Ky proces është i mirërregulluar në dispozitat ligjore të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Bazuar në kriteret e përcaktuara në pikën 3, të nenit 39, të këtij ligji, si dhe në përmbushje të funksionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor sipas pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe sipas shkronjës “b”, të nenit 86, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli propozon caktimin në pozicion të secilit gjyqtar të emëruar duke mbajtur në konsideratë së pari, renditjen e tyre në listat përkatëse të të diplomuarve të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës dhe së dyti, për aq sa është e mundur, preferencat e tyre.

Lidhur me caktimin në pozicion në gjykata administrative të shkallës së parë të shpallura nga Këshilli, mbahen në konsideratë edhe dy kërkesat alternative të pikës 5, të nenit 39, të Ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, sipas të cilit “*I emëruari që caktohet në pozicion në gjykatat administrative, duhet të ketë përvojë pune në të paktën një vit e gjysmë në administratën publike ose të ketë rezultate ‘shumë të mira’ në lëndët e së drejtës administrative në Shkollën e Magjistraturës*”.

Për sa i përket nocionit “*lëndët e së drejtës administrative*”, ligji i referohet konkretisht programeve “E drejta administrative” dhe “E drejta tatimore dhe e drejta doganore”, të cilat zhvillohen gjatë vitit të parë akademik, në Shkollën e Magjistraturës.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!